



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T I

Nga procesverbali i mbledhjes së 38-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.01.2025, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Shefki Bytyqi, anëtar
3. Gazmend Qerkini, anëtar
4. Shkelzim Olluri, anëtar
5. Albiona Tasholli, anëtare
6. Nexhemdin Lekiqi, anëtar
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Sami Bytyqi, anëtar
9. Fitim Shala, anëtar
10. Xhyzide Rrustemi, anëtare
11. Rinor Murati, anëtar
12. Armend Grajqevci, anëtar
13. Gentianë Hoxhaj, anëtare
14. Venhar Agushi, anëtar
15. Majlinda Sylejmani, anëtare
16. Xhyla Dedushaj, anëtare
17. Lulzim Rrustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
22. Ganimete Qeriqi, anëtare
23. Alban Salihu, anëtar
24. Fitim Meziu, anëtar
25. Fadil Spahiu, anëtar
26. Fatmir Fetahu, anëtar
27. Shahadije Dragaçina, anëtare
28. Besiana Sylja, anëtare
29. Enver Kryeziu, anëtar
30. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Diamant Bytyqi, Nënkyetar i komunës
3. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i komunës
4. Latif Ramadani, DBF
5. Shkelzen Hajdini, DSHMS
6. Elmaze Behluli, DA
7. Sead Aliu, DI
8. Valon Pacolli, DEZH
9. Rexhep Rexhepi, DBP
10. Rasim Hasani, DKA
11. Safete Amerllahu, DGJK
12. Burim Rrustemi, DSHPMSH
13. Imri Semetishti, DUPMM
14. Anila Reqica-Llugiqi, DKRS
15. Përfaqësues të mediave dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit, tha se uroj që jeni mirë, po ashtu tha se ju uroj vit të mbarë duke ju dëshiruar shëndet dhe suksese. Në vazhdim tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë me kohë, pastaj lexoi rendin e ditës të propozuar:

REND DITE

1. **Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të (të jashtëzakonshme) dhe 37-të e Kuvendit.**
2. **Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2024.**
3. **Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-10.**
4. **Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-11.**
5. **Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-12.**
6. **Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Konjuh.**

7. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

8. Propozim Vendim paraparak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Pastaj tha se me propozim te ekzekutivit dhe me rekomandim të KPF-së e keni edhe një pike shtese të cilën do ta arsyetoj drejtori i DKA-së ne vazhdim. :

10. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit

Rasim Hasani, tha se rregullorja për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve kërkon që për çdo konkurs të zgjidhet një komision ad hoc dhe kjo po na krijon telashe për shkak se po duhet me shpall konkursin, pastaj komisionin me votua në kuvend. Pres nga ana juaj të votoni këtë propozim vendim.

Pastaj Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës me piken e propozuar dhe pas votimit u konstatua se me 29 vota për, u aprovua rendi i ditës.

Pastaj u kalua në pyetjet e anëtarëve të kuvendit?

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit fillimisht ju uroj një vit te mbar për të gjithë, pastaj tha se së pari kam një kërkesë të ripërsëritur, vjen nga disa banorë që jetojnë mbrapa mullirit bereqeti afër fshatit Bujari, të cilët kanë problem me kanalizimin, janë më shumë se 10 shtëpi dhe nuk po mundën me u kyç ne kanalizimin kryesor. E dyta është një ankese e pronarëve të lokaleve përgjatë rrugës “Skënderbeu” te cilët po ankohen se para lokaleve të tyre po parkohen automjete që qëndrojnë ter ditën para lokaleve të tyre dhe po ju pamundësohet të bëjnë qarkullim normal. Është mirë në bashkëpunim me policinë me bërë një zgjidhje me ju ndihmua këtyre bizneseve.

Besiana Sylja, tha se e kam një kërkesë për emërtimin e një rruge në lagjen e Akllapit dhe shpresoj qe këtë problem organet komunale ta përfundojnë sepse banoreve të asaj pjese po ju shkakton pengesa në formularët që duhet ti plotësojnë në raport me punët e përsëritshme qoftë aplikime konkurse vendimmarrje dhe regjistrime të ndryshme të dokumenteve.

Bashkim Budakova, tha se kam pyetje për ekzekutivin për një kërkesë timen e adresuar disa here ne kuvend, behet fjale për rregullimin e një ure ne lumin Sitnica në

fshatin Rubovc. Nga burime prej disa qytetarëve mora informate se kjo urë do të rregullohet shume shpejtë. Dua te dije se a është ky premtim elektoral, shpresojmë që mos te jetë premtim elektoral por premtim qe do të realizohet. E dyta shkollat janë institucione edukative arsimore, një fenomen qe e kam vërejt këto dite, pjesëmarrja e drejtorëve në fushata elektorale. A është kjo pjesëmarrje e imponuar apo vullnetare nga ana e tyre.

Alban Salhiu, tha se i kam dy pyetje për drejtorin e Urbanizmit, e para ka te beje me objektin te nënkalimi përballë Check-in para disa muajve kane filluar rrënimet por qe disa muaj janë ndalë a e dini arsyen pse janë ndalë rrënimet. Dhe pyetja e dytë a mund ta konfirmosh qe ndërtimet që kanë filluar muajt e fundit a janë komfor në përputhshmëri me harta zonale.

Shahadije Dragaçina, tha se unë do ta ngris një problem qe po vazhdon tash e 8 muaj për pagesa të mëditjeve për anëtarët e komitetit për komunitete që nuk janë pjese e kuvendit. Dhe ata tash në shenjë revolte nuk kanë mbajt fare mbledhje të komitetit në vitin 2025 dhe kjo është një pasqyre jo e mirë. Dhe për këtë duhet te bëhet një zgjidhje. Unë personalisht jam interesuar, dhe kam biseduar me Ministrinë e Financave dhe sipas tyre është përgjegjësi e komunave dhe kjo nuk është ne rregull nga ana juaj, por duhet të gjendet një zgjidhje.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se çështja e pagesave të komuniteteve dhe komisioneve është në krejt Kosovën jo vetëm te në Lipjan. Nëse keni informatë që vetëm një komunë po i paguan ju lutem na sjellin modelin e pagesës dhe në do të vazhdojmë me pagesa. Ka vullnet për pagesë mirëpo nuk po ka shkrese apo të paktën një email nga Ministria.

Egzona Bytyqi, tha se unë do te fokusohem te shëndetësia, ku kohën e fundit jemi dëshmitar se është rrit numri me virozë të kohës. Ku shfrytëzoj rastin që të ju bëjë thirrje qytetarëve të komunës tonë sidomos atyre me sëmundje kronike dhe ata me imunitet të dobët të vaksinohen. E kam edhe një rekomandim për QKMF, pasi që shërbimi që më së shumti është kërkuar është shërbimi parenteral ku bënë pjesë edhe dhënia e infuzioneve dhe nuk ju ka mjaftuar hapësira dhe brenga ma e madhe ka qenë e atyre qe janë me sëmundje malinje, ku është dashtë të paktën të improvizohet një vend.

Nexhmedin Lekiqi, tha se kam disa kërkesa e para, rruga që lidhë fshatin Gadime me fshatin Llugaxhi që kalon ne fshatin Gllavicë ka nevoje për riparim, po ashtu është një kthese aty që kanë nevoje për shenjëzim te varrezat ne Gllavicë. E dyta

ne fshatin Llugaxhi duhet te këtë nevojë për me rregulluar një stacion pasi qe mund te këtë reshje te shiut dhe aty shkakton probleme.

Rinor Murati , tha se kam dy çështje për ti adresuar e para ka të bejë me ndriçimin publik ku në disa fshatra ka nevojë për ri funksionalizim a është ndërmarr diçka rreth kësaj çështje. Çështja e dytë ne kemi marr një vendim ne kuvend për kompensim të dëmeve në bujqësi nga fatkeqësitë natyrore mirëpo deri tani pagesat nuk janë realizuar a keni ndonjë informate rreth kësaj.

Gentianë Hoxhaj, tha se pas interesimit të shume studentëve kam një pyetje për drejtorin e DKA-së, deshta me dite se deri ku kane arrite procedurat për ndarjen e bursave për studente.

Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës tha së së pari ju uroj punë të mbar dhe suksese edhe këtë vit. Sa i përket kanalizimit në fshatin Bujari kemi kontrate për mirëmbajtje të kanalizimit, kemi kontrate dhe drejtoria përkatëse do ti marr masat me intervenuar. Sa i përket parkingjeve ajo është e dedikuar për parking dhe nuk kemi diçka qe mund te masim se sa qëndrojnë aty veturat. Sa i përket emërtimit te rrugëve komisioni është në fazën përfundimtare dhe shumë shpejt do te emërtohen ato rrugë që janë pa emërtim. Ndërsa rrugët e emërtuara nuk do te preken një herë. Rregullimi i urës në Rubovc ka qenë kërkesë e më hershme por për momentin nuk ka mjete. Sa i përket pagesave jashtë listës se pagave nuk kemi ende një rregullore apo udhëzim administrativ për pagesën e tyre. Edhe ne i bashkëngjitëmi apelit për vaksinën e gripit sezonal. Sa i përket stacionit në Llugaxhi është kompetence e ministrisë ajo rrugë por nëse kemi mundësi do ta bëjmë. Te rruga te kthesa ne Gllavicë do te vendosen shenjat. Ndriçimi publike është në procedurë të ankimimit. Bursat janë në fazën përfundimtare fazën e vlerësimit dhe do të procedohen për publikim.

Imri Semetishti, tha se sa i përket njërit objekt urbanizmi ka lëshuar leje të rrënimit, ndërsa sa i përket objektit tjetër ne si drejtorat nuk kemi lëshuar leje të rrënimit sepse nuk janë arritur te gjitha marrëveshjet që i ka pronari i tokës. Sa i përket çështjes se dytë se ndërtimet e fundit a po bëhen në përputhje me hartën zonale, me përgjegjësi të plotë ju them se të gjitha ndërtimet janë ne përputhje me hartën zonale.

Shkelzen Hajdini, tha se sa i përket rritjes se shërbimit te infuzioneve ne e kemi trajtuar këtë temë, mirëpo me udhëzimin administrativ e ndalon ofrimin e shërbimeve për tretësira pasi që infuzionet janë shërbime spitalore. Me gjithë atë ne jemi duke i dhënë këto për te mirën e qytetarëve. Por na tani japim shërbime 24 orë në shtëpi për

te gjithë ata qe kanë nevojë, po ashtu edhe ata qe kanë nevojë për vaksine mund ta marrin.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 36-të (të jashtëzakonshme) dhe 37-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi pyeti a ka vërejte apo plotësime rreth ekstraktit nga mbledhja e 36-të (të jashtëzakonshme) dhe 37-të e Kuvendit.

Meqë nuk pati vërejte as plotësime Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, vuri në votim ekstraktin nga mbledhja e 36-të (të jashtëzakonshme) dhe 37-të e Kuvendit, pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 30 vota për , aprovoi Ekstraktin nga mbledhja e 36-të (të jashtëzakonshme) dhe 37-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II

Raporti i shpenzimeve dhe të hyrave Janar-Dhjetor 2024.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi , Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj Kryesuesi e hapi diskutimin?

Albiona Tasholli, tha se e kemi lexuar dhe analizuar raportin, pavarësisht sfidave dhe pengesave administrative të shkaktuara nga OSHP-ja. Komuna prapë ka arritur të tregoj një performancë të shkëlqyer në realizimin dhe menaxhimin e buxhetit. Kjo arritje është një dëshmi e një qeverisje të përgjegjshme dhe transparente. Komuna do të vazhdojë të jetë një model suksesi për të gjithë.

Lulzim Rrustemi, tha se unë shkurtimisht do ta laboroj. Nga granti qeveritar kemi shpenzim 94% po ashtu ka të hyra vetanake 94% mbi 80 % të hyrat e bartura po ashtu edhe nga donacionet një shumë e mirë e shpenzuar. Në përgjithësi shpenzimi i buxhetit është 97% Por mbi 240 mijë euro kanë shkuar suficit. Sipas kategorive ekonomike një shfrytëzim i mirë. Te DKRS-ja, janë mbet disa mjete pa u shpenzuar. Te investimet kapitale të qendra multifunktionale dhe shtëpia e kulturës dhe të vendosja e barit sintetik në fushat sportive në Dobrajë ,Magurë një shumë e madhe ku të dyja kanë shkuar mjetet suficit. Kam pyetje a me të vërtet janë shpenzuar krejt mjetet për këto projekte. Pasi që të dy projekte zero janë. Pra projektet nuk janë

askund e mjetet janë shpenzuar. Mbledhja e taksave për leje të ndërtimit është e mirë. Por te qiraja e objekteve publike dhe për treg të hapur është jo mire, kam pyet dhe më herët.

Besiana Syla, tha se në baze të raportit shifet se komuna ka shpenzuar buxhetin mbi 97% një shifër e kënaqeshe. Por nëse e analizojmë ne detaje shihet që ka suficit. Kam një pyetje pse komuna me shkuar suficit një shumë kaq të madhe kur dihet nevojat dhe kërkesat e mëdha të qytetarëve. Po ashtu ne raport shifet që edhe rezerva prej 30 mije euro që nuk është shpenzuar. Për çka ka shërbyer kjo rezerve. Te projekti ndërtimi i qendrës multifunktionale janë shpenzuar vetëm një shumë e mjeteve. Te ekzekutimi nga thesari janë marr mjete për vendime gjyqësore por nuk ceket projekti konkret ku janë marr mjetet. Te tatimi në pronë ka të hyra më pak se në vitin e kaluar 90 mije euro. Çka është brengosëse për Komunën e Lipjanit është sepse komuna ka hyre ne obligim pa zotim të mjeteve.

Shahadije Dragaçina, tha se e kam një pyetje te investimet kapitale për vitin 2024 po e shoh që po figuron edhe ndërtimi ofiçient i shkollave Rucit të Ri, Topliqanit dhe Janjevës që janë shpenzuar 240 mije euro. A bene një sqarim pse ka hyre këtu edhe shkolla e Janjeves.

Latif Ramadani, tha se unë e thash edhe me herët është një raport real për çdo shifër të shpenzuar. Te ekzekutimi, thesari i ka ekzekutuar mjetet te qendra multifunktionale dhe te stadiumet. Qiraja është e ulët sepse e kemi fale qiranë lokaleve te rruga "Lidhja e Prizrenit" në kuvend për shkak te punimeve te nënkalimit. Ne kemi një shpenzim shume të mire dhe jemi nder komunat më se miri që e kemi shpenzuar.

Besiana Syla, tha te raporti te rezervat janë 30 mije euro, nuk janë shpenzuar hiç, kanë shkuar suficit. Pse këto mjete me ju shkuar suficit? Po ashtu edhe te qendra multifunktionale një pjesë e mjeteve të ka shkuar suficit.

Arsim Jashari, tha se do te ndalem te një çështje që kemi diskutuar edhe me herët, me tu ekzekutuar mbi 1 milion e 700 mije euro dhe shteti jon me gjithë këto ligje mos me mujt ta bëjë një zgjidhje kjo është shqetësuese si shoqëri, pasi na vetëm shpenzime te administratës sa janë paguar dhe kjo po na qet prej sistemit sepse me këtë po dëmtohen dhe qytetari edhe komunat.

Latif Ramadani, tha se ekzekutimet e thesarit, ne nuk mundemi me i ndaluar. Te rezervat ka qenë një projekt prej 30 mije euro, disa kane shkuar suficit disa i kane marr përmbaruesit.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është mirë që është shpenzuar buxheti shume mirë edhe për këtë duhet falënderuar ekzekutivin, zyrtaret e komunës dhe te gjithë ata qe kane kontribuar.

Meqë diskutime tjera nuk pati u kalua ne piken ne vazhdim.

III

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-10.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, tha se propozoj qe drejtori ti arsyetoj të 3 pikat, pastaj votojmë secilën veç e veç. Me pas ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se ne natyrisht do të votojmë kundër për dhënien e këtyre pronave. Pasi qe njëra nga kompanitë qe e ka fituar këtë pronë, vajza e këtij përfituesit është kandidate për deputete nga radhët e LDK-së. Kryetari i komunës po e trajton pronën e komunës si pronë private të vetën.

Lulzim Rrustemi, tha se është mirë që për zonat ekonomike përgjithësisht po rritet interesimi i kompanive, edhe zona e Babushit ka mare një interesim shume të madh. Komisioni ka bere një punë te mire korrekte dhe këto i kane fituar ne baze te kriterëve , procesi ka qenë i rregullt i sakte.

Nexhemdin Lekiqi, tha se ne si kuvend e kemi votuar vete këtë komision dhe ja kemi besuar punën dhe këta e kane përgjegjësinë e vete.

Latif Ramadani, tha se komisioni ka bere një pune shume te madhe duke e analizuar çdo detaj, dhe e bartim përgjegjësinë për punën qe e kemi bere.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 21 vota për,3 kundër dhe 2 abstenim, aprovoi propozimin

IV

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-11.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për,3 kundër dhe 2 abstenim, aprovoi propozimin

V

Propozim Vendim për miratimin e ofertës së përzgjedhur nga komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Babush i Muhaxherëve P-71409059-00559-12.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Latif Ramadanit drejtor i DBF i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për,3 kundër 2 abstenim, aprovoi propozimin.

Arsim Jashari, tha se ne emër te grupit të PDK-së, i mbështesim këto propozim vendime sepse ato prona duhet me u dhënë.

Lulzim Rrustemi, tha se kam një pyetje këto prona a janë dhënë ndonjë here a janë te lira dhe a kemi probleme ligjore me këto prona. Po presim një sqarim?

Valon Pacolli, tha se këto prona kane qenë më herët te një shfrytëzuesi, janë te lira dhe nuk kanë probleme ligjore.

VI

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës në Zonën Kadastrale Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 3 abstenim, aprovoi propozimin

VII

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës të paluajtshme të Komunës në ZK Konjuh.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacollit drejtor i DEZH i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Gentianë Hoxhaj, tha se në emër të grupit të LDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Albiona Tashollin

Arsim Jashari, tha se në emër të grupit të PDK-së, për anëtar të komisionit e propozojmë, Lulzim Rrustemin

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenim, aprovoi propozimin

VIII

Propozim Vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi drejtor i DBPZHR i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne emër te grupit te PDK-së, e mbështesim këtë propozim.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 22 vota për, 3 abstenim , aprovoi propozimin

IX

Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, ia dha fjalën Rexhep Rexhepi drejtor i DBPZHR i cili, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Albiona Tasholli tha se në emër te grupit të LDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Gentianë Hoxhaj

Arsim Jashari tha se në emër te grupit të PDK-së, për anëtar te komisionit e propozojmë Lulzim Rrustemin

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 24 vota për, 3 abstenim, aprovoi propozimin

X

Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i kuvendit, Daut Azemi, në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 vota për, 4 abstenim, aprovoi propozimin

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 13:10.

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi